




Pranimar / Dorezuar Priljenen / Delivered		08. 12. 2021	viti god year
Organ / Njësia Org / Jednica Org / Unit	Nr / Prot Pr. No	Titull / Titre / Funksion / Functio	Sasia Kolicina Quantity
SKRPI/MIU	5879/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.909/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, dhe Avdyl Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2322/19 të datës 27.10.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.401/2019 të datës 16.07.2019 të parashtruar nga ankuesja me adresë fshati Shakovicë në Podujevë, kundër organit të punësimit/Agjencia e Shërbimit të Navigacionit Ajror, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 08.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.401/2019 të datës 16.07.2019 të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja ka aplikuar në konkursin e shpallur me datë 17.04.2019 për pozitën e punës "Inxhinier në Divizionin e Navigimit" dhe "Inxhinier në Divizionin e Survejimit" në kuadër të Agjencisë së Shërbimit të Navigacionit Ajror, në të cilin konkurs ankuesja nuk është për zgjedhur si kandidatë e suksesshme.

E pakënaqur me njoftimin e datës 24.05.2019, ankuesja me datë 18.06.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë së Shërbimit të Navigacionit Ajror.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Agjencisë së Shërbimit të Navigacionit Ajror, me datën 10.07.2019, ka nxjerr Vendim me Nr. Prot:0400 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar.

Kundër Vendimit me Nr.Prot:0400 të datës 10.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Agjencisë së Shërbimit të Navigacionit Ajror, ankuesja me datë 17.07.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 28.07.2019, ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Agjencia e Shërbimit të Navigacionit Ajror. Këshilli me datë 09.08.2019 ka pranuar përgjigjen se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Në mungesë të kuorumit për vendosje në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesi të njëjtën kohë ka hapur edhe konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 27.10.2021 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.2322/19, përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e datës 16.07.2019 të parashtruar nga ankuesja

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesë e datës 16.07.2019 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 18.06.2019 të ankueses në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm; Emailin e datës 25.09.2018; Vendimin me Nr. Prot:0400 të datës 10.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit; Emailin e datës 16.07.2019 nga ankuesja për ankesa.kpmsk@rks-gov.net; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 23.07.2019; Përgjigjen në ankesë e datës 09.08.2019; Konkursin e datës 17.04.2019; Regjistrin e aplikacioneve të pranuar; Vendimin e datës 15.05.2019; Akt Emërimet e anëtarëve të Komisionit; Njoftimin e testit me shkrim i datës 16.05.2019; Testin me shkrim të datës 17.05.2019 për ankuesen; Formularët e vlerësimit të kandidatëve për vendin e punë për të cilin kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Raportin e rekomandimit nga komisioni rekrutues; Formularin për renditjen përfundimtare të kandidatëve; Njoftimin e datës 24.05.2019; Emailin e datës 09.07.2019, 08.07.2019 nga Emailin e datës 08.07.2019 nga Kërkesën për punësim të ankueses e datës 25.04.2019; Shkresën e datës 06.06.2018 nga Ministria e Administratës Publike; Emailin e datës 30.05.2019 nga Njoftimin e datës 06.09.2019 për ankuesen dhe Aktgjykimin A.nr.2322/19 të datës 27.10.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se janë përmbushur kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar me ankesën A.nr.401/2019 të datës 16.07.2019, *sepse:*



Bazuar në provat e lëndës rezulton se Agjencia e Shërbimit të Navigacionit Ajror, me datë 17.04.2019 ka shpallur konkursin për plotësimin e pozitave të punës Inxhinier në Divizionin e Navigimit dhe Inxhinier në Divizionin e Survejimit, me nëpunës civil të jo karrierës në afat prej 24 muajsh.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke iu referuar shkresave të lëndës ka konstatuar se në kohën e shqyrtimit të ankesës, periudha e kontratës 24 muajsh e parapare për nëpunësit e përzgjedhur, ka kaluar, dhe si rrjedhojë objekti për të cilin është iniciuar procedura gjegjësisht pretendimi ankimor për anulimin e konkursit me numër reference ASHNA/REK/019-2018 është bërë i pamundur, në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë.*


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.909/2021

Avdyll BEKTESHI


Procesmbajtës

Jeton KOÇA


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Agjencisë së Shërbimeve të Navigimit Ajror;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Shërbimeve të Navigimit Ajror; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së